

**AKT THEMELIMI
DHE
STATUT
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
" VENUS VENTURES " SHPK**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", i ndryshuar, themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "VENUS VENTURES" SHPK, veprimitaria e së cilës do të organizohet dhe drejtohet sipas dispozitave të këtij Statuti.

Neni 1

Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë veprimitarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi si dhe në përputhje me dispozitat e këtij Statuti.

Neni 2

Ortakët e shoqërisë

Kjo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar themelohet nga ortakët:

- **Zj. Amantia Xhafaj**, e bija e Fatmirit, e lindur në Tiranë më 31.03.1990 dhe banuese në Tiranë, e identifikuar me anë të Passaportës me Nr. BE5028370 dhe me Nr. Personal J05331058G (këtu e më poshtë referuar edhe si 'Ortaku').
- **Z. Ditjon Baboçi**, i biri i Agim, lindur në Tiranë më 15.11.1986 dhe banues në Tiranë, i identifikuar me Letërnjoftimin Elektronik me Nr. Personal I61115052H (këtu e më poshtë referuar edhe si 'Ortaku').

Neni 3

Forma ligjore

Shoqëria ka formën e "shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar" ose "SHPK". Megjithatë, ajo mund të shndërrohet në një formë tjeter në përputhje me legjislacionin shqiptar.



Statut
“Venus Ventures” SHPK

Neni 4

Kohëzgjatja e veprimtarisë

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është i pacaktuar. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 5

Selia

- 5.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: “Bulevardi Bajram Curri”, Kullat Binjake, Kulla nr. 1, përballë Kuvendit, Kati 14, Apt. 49, Tiranë, Shqipëri.
- 5.2 Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në cilësinë e ortakut ose aksionerit në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

Neni 6


Dokumentet e shoqërisë

- 6.1. Të gjitha shkresat, formularët e urdhreve apo çdo dokument tjetër korrespondence, nxjerrë nga shoqëria, degët apo zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë, përveç emrit të shoqërisë edhe të dhënat e mëposhtme:
 - a) *numrin unik të identifikimit;*
 - b) *formën ligjore të shoqërisë;*
 - c) *vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;*
 - ç) *të dhëna nëse shoqëria është në likuidim;*
 - d) *vlera e kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe vlera e pjesës së paguar të kapitalit;*
- 6.2. Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen aty.

Neni 7

Objekti i veprimtarisë

- 7.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:



2

Statut
“Venus Ventures” SHPK

- Dizenjim software. Analizë, projektim i arkitekturës së një sistemi software. Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software. Programimi i sistemeve software, kodimi, instalimi, integrimi i të gjithe komponenteve, dokumentimi, identifikimi dhe korrigimi i gabimeve, modifikimet dhe mirëmbajtja e të gjithë komponenteve, suporti i sistemit. Testim software. Testim i funksionaliteteve, ngarkesës në punë, performancës, disponueshmërisë dhe sigurisë së sistemit software. Dizenjim dhe zhvillim sistemesh komunikimi. Analizë planifikim, projektim, zbatim, vendosje në punë dhe mirëmbajtje e sistemeve të komunikimit të rrjeteve të pajisjeve informatike. Dizenjim dhe zhvillim sistemesh të sigurisë. Analiza e kërkesave të sigurisë së klientit, projektimi i arkitekturës, instalimet dhe konfigurimet e komponenteve, vendosja në punë, testimet e sigurisë dhe mirëmbajtja. Zhvillim sistemesh migrimi. Transferimi i të dhënave dhe infrastrukturës përkatëse nga një teknologji e vjetër në një teknologji të re. Përmirësim/upgrade sistemesh informatike. Operimi, manaxhimi, suporti i përdorimit, trajnimi dhe auditimi teknik/informatik për sistemet softëare.
- Studio Projektimi, Mbikqyrje dhe Kolaudimi si dhe ofrimi i shërbimeve dhe konsulencave profesionale lidhur me fushat përkatëse. Projekte dhe zbatime të ndërtimeve civile, industriale, turistike, bujqësore. Projekte dhe zbatime interieresh. Studime, planifikime, vlerësime, projekte dhe zbatime urbanistike. Projekte dhe zbatime peisazhi dhe sistemimi. Studime, projekte dhe zbatime produktesh. Studime, projekte, dizenjime dhe zbatime për market. Studime, projekte dhe zbatime të inxhinierisë së ndërtimit, inxhinierisë elektrike dhe inxhinierisë hidromekanike. Projekte konstruktive dhe supervizim punimesh. Studime e projekte dhe zbatime hidrogjeologjike dhe gjeologjike. Projektim dhe zbatime fotogrametrik, hartografik, topografik. Studime fizibiliteti. Projekte dhe zbatime rrugësh, urash, porte turistike. Projekte dhe zbatime linjash dhe sistemesh së prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike. Projektim ujësjellës, kanalizime, vepra ujitje, kullimi, impiante vaditëse, diga, etj. Restaurime dhe konsulenca për shërbimet e mësipërme.
- Ndërtim objektesh të përmasave të ndryshme, shtëpi, vila, ndërtesa shumëkatëshe ose komplekse pallatesh, punime mirëmbajtje, shërbim fasade. Ndërtim rrugësh dhe urash si dhe ndërtime portuale, detare dhe ajrore si dhe rikonstrukcionin e tyre. Asfaltim dhe veshje me asfaltim. Ndërtim digash, galeri, tunele, damba. Ndërtim vepra kullimi, ujitje,

Statut
“Venus Ventures” SHPK

impiante vaditeze, punime mbrojtje dhe sisteme hidraulike, punime dhe sistemime elektrike. Import-Eksport të artikujve të ndryshëm.

- Tregëtim mallrash brenda dhe jashtë vendit. Për të realizuar objektin dhe qëllimin e saj, Shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvillojë çdo lloj aktiviteti tjetër të lejuar nga ligji vetëm ose në bashkëpunim me palë të treta, nëpërmjet nënkontraktimit, qoftë ky aktivitet tregtar, juridik, financiar, promocional, etj që e vlerëson të dobishme.
 - Analizë pasqyrash financiare, këshillimi biznesi me synim përmirësimin e performancës së sistemeve kontabël, ndërtimin e planit të llogarive kontabël, hartim i rregullave të brendshme të shoqërive tregtare, trajnime kontabël, due-diligence financiare dhe operacionale, vlerësimë të biznesit, kërkime dhe analiza të tregut, këshilla në qeverisje dhe menaxhime të riskut.
 - Aktivitet në fushën e pasurive të paluajtshme, vlerësimin e pasurive të paluajtshme, shërbim ndërmjetësimi në shitjen e pasurive të paluajtshme si dhe çdo lloj pasurie, shërbim ndermjëtesimi në dhenie dhe marrje me qira të pasurive të paluajtshme, këshillime për menaxhim biznesi, shërbim ndërmjetësimi për shitje biznesi, si dhe çdo shërbim tjetër në lidhje me tregun imobiliar në të gjithe nivelet e shërbimit.
 - *Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie tjetër që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.*
- 7.2 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.

Neni 8

Kapitali themeltar

- 8.1 Kapitali themeltar i shoqërisë do të përbëhet nga kontributi themeltar i Ortakëve Themelues të kësaj Shoqërie në para, në vlerën **200,000 (dyëqind mijë) lekë**.
- 8.2 Kapitali përbëhet nga 2 (dy) kuota, me vlerë nominale **100,000 (njëqind mijë) Lekë** secila dhe zotërohet nga Ortakët e Shoqërisë, e ndarë në këto raporte:

Ortaku Themules:

Amantia Xhafaj, zoteruese e një kuote me vlerë të përgjithshme **100,000 (njëqind mijë) Lekë**, që përbën **50 %** të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë.



Statut
“Venus Ventures” SHPK

Ortaku Themules:

Ditjon Baboçi, zoterues i një kuote me vlerë të përgjithshme 100,000 (njëqind mijë) Lekë, që përbën 50 % të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë.

Neni 9

Transferimi i pjesëve të kapitalit

- 9.1 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve nëse Asambleja e Ortakëve do të marrë vendim për shndërrimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në një ose më shumë së dy ortakë. Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm në rast trashëgimie, në rast ndarje pasurore mes bashkëshortëve apo paraardhësve e pasardhësve.
- 9.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme tek të tretët, qofshin këta subjekte shqiptarë apo të huaj, persona fizikë apo juridikë.

Neni 10

Zmadhimi/zvogëlimi i kapitalit

- 10.1 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve si dhe në përputhje me kërkesat ligjore.
- 10.2 Ortakët, me kërkesë të thjeshtë të administratorit, në mënyrë unanime dhe në përpjesëtim të drejtë të kuotave që posedojnë, mund të përbushin nevojat financiare të shoqërisë nëpërmjet rritjes së kapitalit ose financimeve (qofshin këto me fitim/interes ose jo), duke respektuar normat e transparencës bankare dhe kërkesat të tjera me karakter fiskal. Rimbursimi i derdhjeve dhe i financimeve te ortakëve mund të bëhet me vendim të ortakëve, siç, me të njëjtat modalitete mund të destinohen për mbulimin e humbjeve eventuale ushtrimore.

Neni 11

Asambleja e Ortakëve

- 11.1 Asambleja e Ortakëve përbëhet nga Ortakët e shoqërisë. Ajo drejtohet nga Administratori i shoqërisë ose nga çdo person tjetër i zgjedhur nga Ortakët.
- 11.2 Asambleja e ortakëve ka këto kompetenca kryesore dhe miraton sa më poshtë vijon:

Statut
“Venus Ventures” SHPK

- *ndryshimi i dispozitave të statutit;*
 - *zmadhimi ose zvogëlimi i kapitali;;*
 - *emërimi dhe ndryshimi i administratorit, likuiduesve dhe ekspertit kontabël;*
 - *miratimi i shpërblimeve të administratorit, likuiduesve dhe ekspertit kontabël;*
 - *miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;*
 - *ndryshimi i formës ligjore të shoqërisë apo riorganizimin e saj;*
 - *miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë;*
 - *mbyllja dhe shpérndarja e parakohshme e shoqërisë;*
 - *çështje të tjera të përcaktuara në legjislacionin shqiptar tregtar në fuqi si dhe nga dispozitat e këtij Statuti në mënyrë të shprehur.*
- 11.3 Asambleja e ortakëve mblidhet të paktën një herë në vit dhe sa herë që duhet të vendosë për çështje të kompetencës së saj.
- 11.4 Të gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në një regjistrer të vendimeve, të dhënët e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) shpérndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) investime;
 - ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.
- 11.5 Mbledhja e Asamblesë thirret nga Administratori ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit themeltar. Asambleja thirret me anë të një njoftimi me shkrim që u dërgohet ortakëve të paktën shtatë ditë përpara datës së mbledhjes. Njoftimi mund t'i dërgohet Ortakut të vetëm edhe nëpërmjet postës elektronike, por në çdo rast duhet të përbajë ditën, orën, vendin si dhe rendin e ditës me çështjet që do të trajtohen.
- 11.6 Ortakët mund të përfaqësohen në mbledhje nga persona të tjera, bazuar në një prokurë të përgjithshme apo të posaçme të lëshuar paraprakisht, prej tyre.
- 11.7 Mbledhja mund të realizohet edhe në distancë si dhe në një vend apo shtet tjetër të ndryshëm nga vendndodhja e selisë së shoqërisë. Ortakët, që nuk janë të pranishëm, mund të marrin pjesë në mbledhjen/t e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme

Statut
“Venus Ventures” SHPK

komunikimi, përfshirë mjetet elektronike vizuale, videokonferencë etj, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:

- a) *transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;*
- b) *komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen përmblledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;*
- c) *mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë se përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, përmarrë pjesë fizikisht në mbledhje.*


Përdorimi i mjeteve elektronike, përmarrë mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme përmarrë garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

- 11.8 Nëse lind nevoja, me propozim të Administratorit, mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mund të zhvillohen në praninë e një Noteri, i cili garanton identifikimin e ortakëve, procesin e votimit dhe vendimarrjen.

Neni 12

Vendimmarrja

- 12.1 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zoterojnë më shumë se 30 % të kapitalit të shoqërisë.
- 12.2 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të kualifikuar, Asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zoterojnë më shumë se 50 % të kapitalit të shoqërisë.
- 12.3 Asambleja e shoqërisë, vendos me 75 % të kapitalit pjesëmarrës (të përfaqësuar nga ortakët), siç parashikohet në pikën 12.2 më sipër, përmblledhjen e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Në rastet e tjera, Asambleja e shoqërisë, vendos me 50 % të votave të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje.



Two handwritten signatures are present in blue ink. The signature on the left is a stylized 'B' or 'J'. The signature on the right is more complex and includes the number '7' above it.

**Statut
“Venus Ventures” SHPK**

- 12.4 Të gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në një procesverbal, ku shënohet data, vendi, rendi i ditës, emri i drejtuesit të mbledhjes dhe mbajtësit të procesverbalit, çështjet kryesore dhe vendimet e marra. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme. Procesverbali nënshkruhet nga Kryetari/Administratori dhe Sekretari (mbajtësi i procesverbalit). Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

Neni 13

Administratori

- 13.1 Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Administratori zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.
- 13.2 Administratori i parë i shoqërisë është: **Z. Ditjon Baboçi**, i biri i, lindur në Tiranë më 15.11.1986 dhe banues në Tiranë, i identifikuar me Letërnjoftimin Elektronik me Nr. Personal I61115052H.
- Administratori i parë është i autorizuar të delegojë të drejtat e saj tek një person i tretë për kryerjen e të gjitha veprimeve proceduriale të nevojshme, me qëllim regjistrimin e shoqërisë "Venus Ventures" SHPK, për fillimin e veprimitarisë sipas objektit të përcaktuar në këtë Statut të nënshkruar nga Ortaktët.
- 13.3 Administratori, ndër të tjera, ka të drejtë të drejtojë veprimtarinë e përditshme të shoqërisë, të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët, të paraqesë para Asamblesë së ortakëve propozime dhe raporte lidhur me aktivitetin e shoqërisë, të çelë llogari bankare në emër të shoqërisë, si dhe të drejta të tjera të cilat mund t'i njihen nga ligji dhe Asambleja e ortakëve.
- 13.4 Administratori ka të drejtë të kryejë çdo veprim brenda kompetencave të tij ose të dhëna me Vendim të Asamblesë së Ortakëve si dhe të krijojë, të ndryshojë apo të dalë nga marrëdhënie juridike me palë të treta.
- 13.5 Administratori mund të delegojë një pjesë të kompetencave të tij për realizimin e veprimeve të caktuara ose kategori veprimesh tek persona të tretë të punësuar ose jo në shoqërinë tregtare, nëpërmjet një Prokure të Posaçme.



**Statut
“Venus Ventures” SHPK**

Të gjitha veprimet juridike të kryera nga Përfaqësuesi me Prokurë, në ushtrim të objektit të veprimtarisë së Administratorit, konsiderohen të vlefshme dhe njësoj si të ishin kryer prej vetë Administratorit.

Veprimet e kryera nga Përfaqësuesi me Prokurë janë të detyrueshme për shoqërinë edhe nëse këto tejkalojnë objektin e saj, kur këto veprime miratohen nga Administratori dhe Ortakët e Shoqërisë, me përjashtim të rastit kur këto veprime shkojnë përtej tagrave të përfaqësimit që u jep ligji apo lejon t'u jepen përfaqësuesve.

Neni 14

Kontrolli finansiar

Asambleja e Ortakëve mund të emërojë një apo disa ekspertë kontabël të cilët kanë detyrën të kryejnë kontrollin kontabël dhe finansiar të shoqërisë.

Neni 15

Viti finansiar

- 15.1 Viti finansiar i Shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.
- 15.2 Si përjashtim, viti i parë finansiar i veprimtarisë së Shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 16

Bilanci dhe Dividendët

- 16.1 Në fund të vitit ushtrimor, administratori, merr masa për përgatitjen e bilancit. Bilanci u paraqitet ortakëve për miratim, brenda afateve ligjore.
- 16.2 Asambleja e ortakëve që miraton bilancin vjetor, vendos mbi shpërndarjen e fitimit ortakëve ose krijimin e rezervave si dhe krijimin e rezervave ligjore.

Neni 17

Likuidimi dhe prishja

Likuidimi dhe prishja e Shoqërisë vendoset dhe kryhet në përputhje me kërkesat ligjore.

Statut
“Venus Ventures” SHPK

Neni 18

Dispozita mbyllëse

- Gjithcka nuk është parashikuar shprehimi i statutit do të rregullohet nga ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar) dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të shoqërisë pranë Qëndrës Kombëtare të Regjistrimit.
- Ky Statut përpilohet në 2 (dy) kopje orginale në gjuhen shqipe dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ortakët themelues.

ORTAKËT THEMELUES
TË SHOQËRISË MË PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“VENUS VENTURES” SHPK

AMANTIA XHAFAJ

Amantia Xhafaj

14/01/2022

DITJON BABOÇI

DITJON BABOÇI